

SEKSIONI I TRETË

Çështja Balkasi dhe të tjerët kundër Shqipërisë

(Kërkesa nr. 14800/18)

VENDIM

Strasburg,

14 qershor 2022

Ky vendim është përfundimtar, por mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Balkasi dhe të tjerët kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komision i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 14800/18) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë më 21 mars 2018, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga pesë shtetas shqiptarë, sipas tabelës bashkëlidhur (kërkuesit);

vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare (Qeveria) për ankesat sipas neneve 3, 8 dhe 14 të Konventës, dhe për të deklaruar pjesën tjetër të kërkesës së papranueshme;

konstatimet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe konstatimet e paraqitura nga kërkuesit si përgjigje ndaj konstatimeve të Qeverisë së paditur;

komentet e paraqitura nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC), për të cilat Kryetari i Seksionit dha leje për ndërhyrje;

pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 24 maj 2022,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

HYRJE

1. Kërkesa ka të bëjë me mungesën e një hetimi penal efikas, në lidhje me deklaratat e besueshme të kërkuesve të dytë, të tretë dhe të pestë, sipas së cilave ata ishin keqtrajtuar nga oficerët e policisë.

FAKTET

2. Kërkuesit janë anëtarë të një familjeje me origjinë etnike rome dhe adresa e tyre sipas faktit që është dhënë në formularin e kërkesës është në Tiranë. Emrat dhe vitet e tyre të lindjes janë paraqitur në shtojcë. Kërkuesit u përfaqësuan nga znj. A. Metalla, një avokate e cila e ushtron profesionin në Tiranë.

3. Qeveria u përfaqësua nga ish-Agjentët e saj znj. A. Hiçka dhe z. A. Metani, dhe në vijim nga z. O. Moçka nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

4. Sipas parashtrimeve të palëve, faktet e çështjes mund të përmbledhen si më poshtë.

I. RAPORTIMI I AUTORITETEVE PËR INCIDENTIN E DATËS 13 DHJETOR 2013

5. Më 13 dhjetor 2013, tre oficerë policie shkuan në ish-banesën e kërkuesve në një fshat në Fier, për të kontrolluar për një person që i ishte fshehur drejtësisë.

6. Policët kishin veshur jelekët e policisë mbi veshjet e tyre normale. Sapo ata iu afruan të arratisurit, ai u largua duke vrapuar. Pas një ndjekjeje të shkurtër, oficerët mundën ta kapnin të

arratisurin në kopshtin e kërkuesve. Pasi i arratisuri u vu nën kontrollin e oficerëve të policisë, ai filloi të thërriste për ndihmë. Për pasojë u mbledh një grup prej të paktën pesëdhjetë personash, duke përfshirë edhe kërkuesit. Oficerët u vetëidentifikuan si oficerë policie dhe treguan kartat e identitetit të policisë.

7. Pjesëtarët e grupit, midis të cilëve kërkuesit ishin anëtarët më aktivë, i gjuajtën oficerët duke i detyruar që të largoheshin nga fshati, pasi nuk do t'i lejonin që të arrestonin të arratisurin. Në këtë mënyrë, oficerët u detyruan të largoheshin pa e arrestuar të arratisurin. Mbrëmjen e asaj dite, ata përgatitën një raport shërbimi për ngjarjet.

8. Më 14 dhjetor 2013, pas një ankese penale të paraqitur nga dy prej oficerëve të policisë në fjalë, një oficer i policisë gjyqësore vendosi se plagët e oficerëve të policisë do të ekzaminoheshin dhe do të përgatitej një raport mjeko-ligjor.

II. RAPORTIMI I KËRKUESVE PËR INCIDENTIN E DATËS 13 DHJETOR 2013

9. Më 13 dhjetor 2013, rreth orës 7 pasdite, kërkuesit dhe familjarët e tyre, me përjashtim të kërkuesit të katërt, ishin në shtëpinë e tyre, kur katër persona me veshje të thjeshta, me maska dhe të armatosur me pistoleta dhe shkopinj druri hynë papritur në kopshtin e tyre. Kur kërkuesi i dytë dhe bashkëshortja e tij i kërkuan këtyre personave që të identifikoheshin, ata e shtynë bashkëshorten e kërkuesit të dytë, ndërsa këtë të fundit e goditën me grushte dhe me tytë e pistoletave të tyre. Kërkuesi i dytë ra dhe filloi të kishte gjakderdhje në buzën e poshtme.

10. Kërkuesi i tretë dhe i pestë ndërhyjnë për të mbrojtur kërkuesin e dytë, babanë e tyre, dhe në vijim u zhvillua një konfrontim i potershëm. Kërkuesin e pestë e goditën me një shkop druri. Njërin prej kërkuesve, i cili nuk u identifikua, e shtynë tek një makinë e parkuar aty pranë, duke thyer xhamin e makinës. Gjithashtu u plagos edhe bashkëshortja e kërkuesit të dytë, bashkëshortja e një pjesëtari tjetër të familjes dhe kërkuesi i tretë.

11. Pasi u mbledhën disa fqinjë, tre nga personat e armatosur u larguan, ndërsa personi i katërt hoqi maskën, duke u identifikuar si oficer policie dhe duke iu kërkuar të gjithëve që të tërhiqeshin. Përpara se të largohej nga vendngjarja, oficeri deklaroi se nëse kërkuesi i dytë do të paraqiste një ankesë penale ndaj tij, ai do të arrestohej pasi kishte penguar një oficer policie.

12. Kërkuesi i parë vuante nga probleme të shëndetit mendor, të cilat kishin ekzistuar që përpara incidentit, dhe pavarësisht se ai ishte në shtëpi gjatë ngjarjes, ai nuk i kishte parë oficerët e policisë teksa kishin hyrë dhe as nuk u përfshi në ndonjë mënyrë me ta. Në kohën e incidentit, kërkuesi i katërt ishte në një zonë aty pranë, dhe u kthye në shtëpi vetëm pasi ishin larguar oficerët.

13. Kërkuesi i tretë telefonoi policinë dhe operatori e këshilloi që të telefononte të plotfuqishmin e lagjes, udhëzim të cilin ai e ndoqi. Sipas këshillës së të plotfuqishmit të lagjes, njëri prej kërkuesve telefonoi Zyrën e Avokatit të Popullit, i cili është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të individëve që përballen me akte të paligjshme nga administrata publike.

14. Më 14 dhjetor 2013, disa familjarë të kërkuesve – është e paqartë se kush konkretisht – shkuan në spital për të marrë raporte mjekësore për plagët që kishin marrë gjatë konfrontimit. Personeli mjekësor iu kërkoi të paraqisnin ankesa penale përpara se të kryheshin kontrollet mjekësore. Për pasojë, kërkuesit shkuan te rajoni lokal i policisë.

15. Gjatë kohës kur familjarët e kërkuesve ishin në rajonin e policisë, oficerët e policisë nuk i morën seriozisht dhe nuk i regjistruan ankesat e tyre. Në një moment, njëri prej oficerëve i cili kishte marrë pjesë në operacionin e policisë u kërkoi të mos bënin ankesë, por u sugjeroi një zgjidhje miqësore. Gjithashtu, ky oficer i policisë kërkoi ndjesë për sjelljen e policisë. Për pasojë, ata nuk bënë një ankesë penale.

III. ANKESA ADMINISTRATIVE PËRPARA AVOKATIT TË POPULLIT

A. Deklaratat e kërkuessve përpara Avokatit të Popullit

16. Në 15 dhjetor 2013, tre oficerë nga Zyra e Avokatit të Popullit u takuan me kërkuessin e dytë dhe të tretë, si edhe me disa nga familjarët e tyre, dëgjuan ankesat e tyre dhe morën deklarata me shkrim në lidhje me ngjarjet e datës 13 dhjetor 2013.

17. Kërkuessit e dytë dhe të tretë, si edhe familjarët e tyre, i përshkruan ngjarjet kryesisht sipas përshkrimit në paragrafët 9–15 më sipër.

18. Kërkuessi i tretë deklaroi se ishte i frikësuar, pasi më 14 dhjetor 2013, disa prej kushërinjve të tij kishin takuar njërin prej oficerëve të policisë të përfshirë në ngjarje, i cili raportohet të ketë deklaruar se “me atë familje do të kem punë unë”. Kërkuessi i tretë kërkoi ndërhyrjen e Shtetit për zgjidhjen e çështjes, pasi familja e tij nuk kishte eksperiencë në çështjet me forcat policore. Në një deklaratë shtesë të datës 17 janar 2014, përpara Avokatit të Shtetit, kërkuessi i tretë deklaroi se si rezultat i presionit të ushtruar nga njëri prej oficerëve të policisë i cili kishte qenë i përfshirë në atë ngjarje, babai i tij – i cili është kërkuessi i dytë – nuk kishte bërë ankesë penale.

B. Hetimi administrativ i realizuar nga Avokati i Popullit

19. Më 26 dhjetor 2013, Avokati i Popullit paraqiti një kërkesë për marrje informacioni pranë autoriteteve lokale të policisë duke ngritur çështjen e mosidentifikimit të oficerëve të policisë gjatë operacionit të datës 13 dhjetor 2013, çështjen e dhunës së përdorur ndaj kërkuessit të dytë dhe familjes së tij, kërcënimet e bëra për ta ndaluar atë që të bënte një ankesë penale dhe mosregjistrimin e ankesës së tij.

20. Në përgjigjen e datës 6 janar 2014, autoritetet policore deklaruan se ata kishin shkuar në fshat për të arrestuar një person që i ishte fshehur drejtësisë. Gjithashtu, ata deklaruan se oficerët e policisë nuk kishin goditur askënd, dhe se kërkuessi i dytë dhe familjarët e tij kishin penguar operacionin.

21. Më 22 janar 2014, Avokati i Popullit paraqiti gjetjet e tij për çështjen tek autoritetet policore në formën e një rekomandimi. Avokati i Popullit përshkruante versionin e ngjarjeve sipas palëve, dhe arrinte në përfundimin se autoritetet policore nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre në disa aspekte. Së pari, më 13 dhjetor 2013, oficerët e policisë nuk kishin veshur uniformat ose ndonjë provë tjetër identifikimi sipas ligjit vendas. Së dyti, ata kishin përdorur forcë të panevojshme ndaj kërkuessit të dytë dhe familjes së tij. Së treti, në kundërshtim me detyrimet e tyre, autoritetet kishin lëshuar raporte mjeko-ligjore vetëm për plagët e oficerëve të policisë, dhe nuk kishin regjistruar ankesat penale të kërkuessit të dytë dhe të familjarëve të tij. Së fundmi, autoritetet policore nuk kishin informuar as prokurorinë përkatëse për këtë incident.

22. Sipas konstatimeve të mësipërme, Avokati i Popullit rekomandonte që autoritetet policore të zhvillonin një hetim në lidhje me ngjarjet e datës 13 dhjetor 2013, për të përcaktuar përgjegjësinë e oficerëve të policisë të përfshirë dhe masat e nevojshme që do të duhej të merreshin për zbatimin e duhur të ligjeve të zbatueshme në të ardhmen. Avokati i Popullit udhëzoi autoritetet policore të informonin zyrën e tij për masat e marra në vijim të rekomandimeve.

23. Rezulton se policia nuk mori asnjë masë në lidhje me këtë situatë.

IV. PROCEDURAT PENALE NDAJ KËRKUESVE

24. Më 16 prill 2014, prokuroria paraqiti një aktakuzë ndaj kërkuessve në lidhje me ngjarjet e datës 13 dhjetor 2013, ku i akuzonte ata se kishin penguar punën e oficerëve të policisë.

25. Si mbrojtje, kërkuessit rideklaruan versionin e ngjarjeve – siç përshkruhen në paragrafët 9–15 më sipër – dhe paraqitën rekomandimin e lëshuar nga Avokati i Popullit, më datë 22 janar 2014 (shih paragrafin 21 më sipër).

26. Gjithashtu, ata ankoheshin se kërkuesi i dytë, i tretë dhe i pestë, midis të tjerëve, ishin lënduar gjatë operacionit të policisë, dhe se autoritetet nuk kishin nisur një hetim për pretendimet e tyre. Kërkuesit cituan një sërë vendimesh të kësaj Gjykate në mbështetje të nenit 3 të Konventës, në mbështetje të argumenteve të tyre.

27. Më 30 korrik 2014, Gjykata e Rrethit Fier i shpalli kërkuesit fajtorë dhe dha dënime me dy dhe katër muaj burgim. Gjykata nuk adresoi pretendimet e kërkuesve sipas së cilave ata ishin keqtrajtuar. Gjykata arsyetoi se deklaratat e oficerëve dhe raportet mjekësore të paraqitura prej tyre mbështesnin akuzën se kërkuesit kishin penguar operacionin e policisë.

28. Më 30 prill 2015, Gjykata e Apelit Vlorë rrëzoi apelin e kërkuesve, por vendosi të pezullonte ekzekutimin e vendimeve me burgim.

29. Pas një apelimi në nivel kasacioni, në të cilin kërkuesit përsërisnin argumentet e mësipërme, më 19 maj 2016, Gjykata e Lartë, e mbledhur me dyer të mbyllura, rrëzoi apelin e tyre me anë të një vendimi *de plano*. Kërkuesit parashtuan se ata ishin informuar për vendimin e Gjykatës së Lartë më 24 maj 2017, dhe se më 29 maj 2017, ata kishin paraqitur një ankesë në Gjykatën Kushtetuese ku paraqisnin kryesisht të njëjtat argumente (shih paragrafin 26 më sipër).

30. Më 29 shtator 2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesat e kërkuesve me argumentin se ishin të vonuara. Ajo theksonte se vendimi i Gjykatës së Lartë ishte marrë më 19 maj 2016 dhe se nuk ishte paraqitur asnjë apelim brenda periudhës katërmujore të parashkrimit.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 3 TË KONVENTËS

31. Kërkuesit u ankuan se trajtimi ndaj tyre nga ana e oficerëve të policisë, më 13 dhjetor 2013, dhe në vijim, moshetimi nga ana e autoriteteve, i pretendimeve të tyre për keqtrajtim, shkelte të drejtat e tyre sipas nenit 3 të Konventës, i cili parashikon:

“Neni 3

Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.”.

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

32. Qeveria parashtroi se kërkuesit nuk kishin shteruar zgjidhjet e brendshme sipas parashikimit të nenit 35 § 1 të Konventës. Ata nuk filluan procedura të brendshme për t’u ankuar për shkeljen e të drejtave të tyre sipas nenit 3 të Konventës. Veçanërisht, kërkuesit mund të kishin paraqitur një ankesë penale në prokurori, një ankesë administrative te Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme për zgjidhje civile për dëmshpërblim.

33. Gjithashtu, Qeveria argumentoi se kërkesa duhet të deklarohej e papranueshme në mbështetje të nenit 35 § 3 (a), duke qenë se ishte shkelur e drejta për petition individual. Në vijim, Qeveria theksonte se kërkesa ishte qartazi e paargumentuar dhe se kërkuesit kishin shndërruar faktet, duke qenë se ata nuk kishin qenë subjekt i trajtimit që është në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Përkundrazi, ata e kishin ushtruar një trajtim të tillë ndaj oficerëve të policisë.

34. Kërkuesit i kontestuan argumentet e Qeverisë. Ata i referuan parashtrimet e tyre te gjykatat vendase në procedura penale të ndërmarra ndaj tyre dhe argumentuan se ata i kishin ngritur ankesat e tyre përpara autoriteteve. Më tej, ata theksonin se i kishin paraqitur ankesat e tyre tek Avokati i Popullit. Ata argumentonin se duhej të kishte nisur një hetim *ex officio* pasi autoritetet të kishin marrë dijeni për pretendimet e tyre për keqtrajtim gjatë operacionit të policisë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Në lidhje me kërkuesit e parë dhe të katërt

35. Gjykata vëren se kërkuesi i parë kishte deklaruar përpara autoriteteve vendase dhe Gjykatës se, edhe pse ishte në shtëpi në datë 13 dhjetor 2013, ai as nuk kishte dëgjuar dhe as nuk kishte ndërhyrë në ndonjë formë ndaj oficerëve të policisë (shih paragrafin 12 më sipër). Në lidhje me kërkuesin e katërt, ai parashtroi se ishte kthyer në shtëpi pasi kishte përfunduar incidenti.

36. Në lidhje me këto parashtime, Gjykata konstaton se kërkuesi i parë dhe i katërt nuk kanë bërë një pretendim të argumentueshëm ose një parashtrim të besueshëm se ata u keqtrajtuat (krahaso gjithashtu *Igars kundër Letonisë* (vendim) nr. 11682/03, § 72, 5 shkurt 2013). Në këtë aspekt, ankesa e tyre nuk është e mbështetur dukshëm në fakte dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4, të Konventës.

b) Në lidhje me kërkuesin e dytë, të tretë dhe të pestë

i. Shterimi i zgjidhjeve vendase

37. Gjykata vëren në fillim të argumentit të Qeverisë se në mënyrë që të shterohen zgjidhjet e brendshme, pjesa e mbetur e kërkuesve do të duhej të kishin ndërmarrë procedura civile dhe administrative për korrigjim të shkeljes së pretenduar të nenit 3. Megjithatë, ajo përsëriti se në aspektin e përdorimit të paligjshëm të forcës nga agjentët shtetërorë, procedurat civile ose administrative me synimin e vetëm për kompensimin e dëmeve, më tepër sesa garantimin e identifikimit dhe dënimin e personave përgjegjës, nuk janë zgjidhje të përshtatshme dhe efektive për ofrimin e korrigjimit për ankesat e mbështetura në aspektin substantiv të nenit 3 të Konventës (shih *Pihoni kundër Shqipërisë*, nr. 74389/13, § 68, 13 shkurt 2018, dhe *Kyriacou Tsiakkourmas dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 13320/02, § 252, 2 qershor 2015). Në vijim parashtrohet se kërkuesit e tjerë në çështjen konkrete nuk kishin detyrimin të shteronin ato zgjidhje.

38. Gjithashtu, Qeveria argumentoi se kërkuesit e tjerë nuk kanë shteruar zgjidhjet e brendshme pasi ata nuk kishin paraqitur një ankesë penale. Në lidhje me këtë aspekt, kërkuesi i tretë pohoi se ankesat e tyre ishin paraqitur tek operatori telefonik i policisë (shih paragrafin 13 më sipër). Gjithashtu, familjarë të ndryshëm ishin përpjekur të bënin ekzaminime mjekësore për lëndimet e tyre dhe kishin shkuar te rajoni lokal i policisë për të paraqitur një ankesë penale. Megjithatë, pretendohet se oficerët e policisë kishin refuzuar të regjistronin ankesat e tyre (shih paragrafët 14 dhe 15 më sipër). Në parashtrimin e kërkuesit të tretë, njëri prej oficerëve të përfshirë kishte kërcënuar madje kërkuesin e dytë që të mos paraqiste një ankesë penale (shih paragrafin 18 më sipër). Në vijim, një arsye tjetër e paraqitur nga kërkuesit e tjerë për të mos dorëzuar një ankesë penale ishte se ata ishin bindur se oficerët e kishin pranuar fajin ndaj tyre.

39. Gjykata vëren me shqetësim se asnjë prej autoriteteve vendase nuk i adresoi ankesat që ishin paraqitur vazhdimisht përpara tyre. Veçanërisht, Avokati i Popullit i kishte kërkuar autoriteteve policore nëse ata e kishin regjistruar ankesën penale të kërkuesit të dytë, por autoritetet nuk kishin bërë asnjë koment për këtë çështje (shih paragrafin 20 më sipër). As parashtrimet e kërkuesve të tjerë nuk ishin adresuar nga Qeveria gjatë procedurave përpara Gjykatës.

40. Në çdo rast, mungesa e një ankese formale nuk i lehtëson autoritetet nga detyrimi i tyre pasi janë bërë me dijeni për çështjen (shih *Gorgiev kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 26984/05, § 64, 19 prill 2012, dhe *El Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [DHM], nr. 39630/09, §186, GJEDNJ 2012). Në lidhje me këtë aspekt, sipas raportit të shërbimit të oficerëve të datës 13 dhjetor 2013, dhe ankesës së tyre të datës 14 dhjetor 2013 (shih paragrafët 7 dhe 8 më sipër), autoritetet vendase ishin në dijeni se në fshatin e kërkuesve kishte ndodhur një konfrontim fizik. Gjithashtu, dy ditë pas incidentit, Avokati i Popullit kishte marrë një sërë deklaratash nga

personat e përfshirë në ngjarje, ku deklarohet se kërkuessit e tjerë ishin keqtrajtuar nga oficerët e policisë. Avokati i Popullit i konsideronte deklaratat të pranueshme në të dyja shkresat e dërguara tek autoritetet policore (kërkesa për informacion – shih paragrafin 19 – dhe gjetjet mbi incidentin, shih paragrafin 21). Së fundmi, gjatë procedurave penale ndaj tyre, kërkuessit u mbështetën në mënyrë eksplicite në nenin 3 të Konventës dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës sipas atij neni, duke ia bërë me dije ankesat e tyre prokurorit dhe gjyqtarëve të përfshirë në ato procedura (shih paragrafin 26 më sipër). Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se pavarësisht mungesës së ankesës formale penale, autoritetet vendase kërkonin që të kishin mjaftueshëm dijeni për parashtrimet e besueshme të kërkuessve të tjerë, për faktin se ishin bërë objekt i një trajtimi i cili ishte në kundërshtim me nenin 3. Në këtë mënyrë, pretendimi i Qeverisë për mosshfrytëzim duhet të rrëzohet.

ii. Respektimi i parashkrimit gjashtëmuajor

41. Në vlerësim të faktit nëse një kërkuess ka respektuar nenin 35 § 1, është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti se kërkesat në atë nen, në lidhje me shterimin e zgjidhjeve të brendshme dhe periudhës gjashtëmuajore, janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën (shih *Jeronovič kundër Letonisë* [DHM], nr. 44898/10, § 75, 5 korrik 2016) dhe se Gjykata nuk mund të anulojë zbatimin e rregullit prej gjashtë muajsh vetëm sepse Qeveria nuk ka ngritur një kundërshtim paraprak për këtë aspekt (shih *Blečić kundër Kroacisë* [DHM], nr. 59532/00, § 68, GJEDNJ 2006-III).

42. Si rregull, periudha prej gjashtë muajsh fillon nga data e vendimit përfundimtar në procesin e shterimit të zgjidhjeve të brendshme. Në çështjet që kanë të bëjnë me një hetim për keqtrajtim, pritët që kërkuessit të marrin hapa në mënyrë që të ndjekin progresin e hetimeve, ose mungesën e tyre, dhe të paraqesin kërkesat e tyre në kohën e duhur pasi të vihen në dijeni, ose duhet të vihen në dijeni, për mungesën e një hetimi efikas penal (shih *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë* [DHM], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, § 263, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)). Identifikimi i kohës së duhur se kur ndodh kjo fazë varet nga rrethanat e çështjes dhe është e vështirë të përcaktohet me saktësi. Për atë kohë sa ka kontakte me autoritetet në lidhje me ankesat dhe kërkesat për informacion, ose ka të dhëna, ose probabilitet real për progres në masat hetuese, nuk do të ketë vonesa të papërshtatshme nga kërkuessit (shih *ibid.*, §§ 266 dhe 269, dhe *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë* [DHM], nr. 16064/90 dhe 8 të tjerë, § 165, GJEDNJ 2009).

43. Në çështjen konkrete, Gjykata është e mendimit se për sa kohë ankesat e kërkuessve të tjerë për keqtrajtim ishin pezull në gjykatat vendase në kontekstin e procedurave penale ndaj tyre, nuk kishte asnjë problematikë në lidhje me respektimin e periudhës gjashtëmuajore. Në të vërtetë, kërkuessit e tjerë argumentonin – dhe Gjykata bie dakord – se parashtrimet e tyre mund të nisin një hetim për pretendimet e tyre. Përderisa ata e paraqitën kërkesën e tyre brenda gjashtë muajsh nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili e rrëzonte apelimin e tyre kushtetues (shih paragrafin 30 më sipër), Gjykata nuk vëren ndonjë vonesë të pashpjegueshme nga ana e kërkuessve.

44. Gjykata nuk lë mënjanë edhe konstatimet e Gjykatës Kushtetuese sipas së cilës apeli i kërkuessve u paraqit përtej afatit katërmujor. Megjithatë, as vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe as parashtrimet e Qeverisë përpara Gjykatës nuk japin ndonjë shpjegim se përse data 19 maj 2016 ishte konsideruar si data e fillimit të afatit katërmujor për të paraqitur një apel në Gjykatën Kushtetuese. Veçanërisht, në dosjen e çështjes nuk rezulton se kërkuessit e tjerë u njoftuan për faktin se çështja e tyre do të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë më 19 maj 2016. Për më tepër, vendimi i Gjykatës së Lartë u mor me detyrë të mbyllura, pra, pa praninë e kërkuessve të tjerë, dhe nuk ka asnjë të dhënë se ata u bënë me dijeni për vendimin, apo se në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës së Lartë gjendej një vendim me shkrim në mënyrë që ata të mund ta tërhiqnin.

Gjithashtu, deklarata e tyre se ata paraqitën një ankesë kushtetuese brenda katër muajsh, më datë 24 maj 2017, kur ata kërkuan të bëheshin me dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë, datë 19 maj 2016, mbeti e pakundërshtuar (shih, *mutatis mutandis*, *Ivanova dhe Ivashova kundër Rusisë*, nr. 797/14 dhe 67755/14, §§ 52–58, 26 janar 2017). Duke marrë në konsideratë sa më sipër dhe cenueshmërinë e kërkuësve (shih *Oršun dhe të tjerët kundër Kroacisë* [DHM], nr. 15766/03, §§ 147–148, GJEDNJ 2010), në rrethanat specifike të çështjes në fjalë, Gjykata pranon se kërkuësit e tjerë respektuan periudhën gjashtëmujore parashikuar në nenin 35 § 1 të Konventës.

iii. Pretendimi për abuzim të së drejtës për kërkesë

45. Për sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës për kërkesë individuale, Gjykata thekson se sipas nenit 35 § 3 (a) të Konventës një kërkesë mund të kundërshtohet si abuzim me të drejtën për kërkesë individuale, nëse, midis arsyesh të tjera, ai mbështetet në fakte që janë dukshëm të pavërteta (shih *Gross kundër Zvicrës* [DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014, me referenca të tjera). Ajo është e mendimit se kundërshtimi i Qeverisë buron nga mosmarrëveshja e palëve për faktet e çështjes. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se versioni i kërkuësve për ngjarjet nuk dukej të ishte abuziv për Avokatin e Popullit, zyrë e cila i regjistroi parashtrimet e tyre dhe ndërmori një hetim administrativ për ankesat e tyre. Në vijim, Gjykata është e mendimit se kërkuësit kanë të drejtën të ofrojnë një përmbledhje alternative të fakteve të çështjes krahasuar me atë të përcaktuar nga autoritetet vendase, pa kaluar automatikisht në abuzim të së drejtës për kërkesë individuale (krahaso edhe *Harachebiev dhe Tolumov kundër Bullgarisë*, nr. 15018/11 dhe 61199/12, § 185, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)). Gjithashtu, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se përshkrimi i fakteve sipas kërkuësve të tjerë çon në abuzim të së drejtës për kërkesë. Prandaj, objeksioni i Qeverisë në këtë aspekt duhet të rrëzohet.

iv. Përfundim

46. Në vijim, Gjykata vëren se ankesa e kërkuësve të tjerë as nuk është dukshëm e pambështetur në fakte dhe as nuk është e papranueshme për arsyet të tjera të listuara në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Cilësitë

1. Parashtrimet e palëve

a) Kërkuësit

47. Kërkuësi i dytë, i tretë dhe i pestë parashtruan se më 13 dhjetor 2013, ata ishin keqtrajtuar nga oficerët e policisë dhe se autoritetet vendase nuk kishin përmbushur detyrimin e tyre procedural për të hetuar rrethanat e ngjarjes.

b) Qeveria

48. Qeveria kontestoi raportimin e ngjarjeve sipas kërkuësve dhe parashtroi se kërkuësit nuk kishin paraqitur ndonjë deklaratë të besueshme se ata ishin bërë objekt i trajtimit që binte në kundërshtim me nenin 3 të autoriteteve vendase. Gjithashtu, ata parashtruan se, në çdo rast, autoritetet vendase kishin hetuar ngjarjet e datës 13 dhjetor 2013 dhe kishin arritur në përfundimin se më shumë sesa ishin keqtrajtuar, kërkuësit kishin qenë ata që kishin penguar oficerët e policisë në realizimin e detyrave të tyre.

c) Ndërhyrësi si palë e tretë

49. ERRC-ja iu referua një sërë raportesh ndërkombëtare ku përshkruhet situata e romëve në Shqipëri dhe parashtroi një sërë pikash që demonstrojnë një formë “anticiganizmi” midis autoriteteve ligjzbatuese.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet përkatëse

50. Gjykata i referohet parimeve të përgjithshme në lidhje me pjesën substanciale të nenit 3, e cila është përmbledhur, midis çështjeve të tjera, në vendimin *Bonyid kundër Belgjikës* [DHM], nr. 23380/09, §§ 81–87, GJEDNJ 2015. Kërkesat për një detyrim procedural për të zhvilluar një hetim efikas janë përmbledhur së fundmi në vendimin *X dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, [DHM], nr. 22457/16, §§ 184–92, 2 shkurt 2021. Veçanërisht, në mënyrë që të jetë efikas, hetimi duhet të jetë i menjëhershëm, i detajuar – që do të thotë se autoritetet duhet të përpiqen seriozisht të konstatojnë se çfarë ndodhi dhe nuk duhet të mbështeten në përfundime të nxituara ose të pambështetura në fakte për të mbyllur hetimin e tyre – dhe duhet të jenë në gjendje të çojnë në identifikimin dhe – nëse është me vend – në dënimin e personave përgjegjës.

51. Gjithashtu, Gjykata theksoi se në të shkuarën mungesa e ekzaminimeve mjeko-ligjore nuk ndihmonte në konstatimin nëse një viktimë e pretenduar kishte marrë lëndime (shih *Shishkin kundër Rusisë*, nr. 18282/04, §117, 7 korrik 2011), dhe nënvizon se kontrollet e duhura mjekësore janë një masë mbrojtëse e rëndësishme ndaj keqtrajtimit (shih *Akkoç kundër Turqisë*, nr. 22947/93 dhe 22948/93, §§ 55 dhe 118, GJEDNJ 2000-X).

b) Zbatimi i parimeve në çështjen konkrete

i. Shkelje e pretenduar e pjesës thelbësore të nenit 3

52. Gjykata vëren se kërkuesi i dytë pretendonte se ishte goditur nga oficerët e policisë me grushte dhe qytat e pistoletave të tyre. Si rezultat i këtyre goditjeve ai kishte rënë dhe kishte pasur gjakderdhje në buzën e poshtme. Kërkuesi i tretë dhe i pestë parashtruan se ishin përfshirë në konfrontim fizik me oficerët e policisë dhe si rezultat ishin lënduar, nga ku kërkuesi i pestë specifikonte se ishte goditur me një shkop druri. Për këto arsye, Gjykata nuk ka dyshime se trajtimi i pretenduar arrin nivelin minimal të ashpërsisë për të kërkuar në këtë mënyrë zbatimin e nenit 3.

53. Mbetet për t'u përcaktuar nëse këto pretendime për keqtrajtim mbështeten nga provat e duhura (krahaso *Labita kundër Italisë* [DHM], nr. 26772/95, § 121, GJEDNJ 2000-IV). Në vlerësim të provave, Gjykata ka adoptuar standardin e provës “përtej dyshimit të arsyeshëm” (shih *El-Masri*, cituar më sipër, § 151).

54. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se Qeveria i mohonte pretendimet e kërkuesve. Në vijim, ajo vëren se Avokati i Popullit konstatoi se policia kishte përdorur forcë të pajustificuar ndaj kërkuesve (shih paragrafin 21 më sipër). Megjithatë, ai konstatim duket të jetë mbështetur kryesisht në deklaratat e kërkuesve. Sipas Gjykatës, konstatimi i Avokatit të Popullit i klasifikon ankesat e kërkuesve të argumentueshme *prima facie*, por ky konstatim në vetvete është i pamjaftueshëm për të mbështetur përfundimin – mbështetur në materialet e disponueshme në Gjykatë – se kërkuesit janë keqtrajtuar.

55. Gjithashtu, në mungesë të të dhënave të mjaftueshme që vërtetojnë pretendimet e kërkuesve, Gjykata e ka të pamundur të përcaktojë përtej dyshimit të arsyeshëm se oficerët e policisë përdorën forcë të pajustificuar ndaj kërkuesit të dytë, të tretë dhe të pestë.

56. Për këtë arsye, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës, sipas pjesës së tij thelbësore për sa i përket kërkuesit të dytë, të tretë dhe të pestë.

ii. Pretendimi për shkelje të aspektit procedural të nenit 3

57. Qeveria parashtroi se autoritetet e brendshme hetuan në mënyrë efikase ngjarjet e datës 13 dhjetor 2013 dhe arritën në përfundimin se kërkuesit e tjerë nuk ishin keqtrajtuar. Megjithatë, Gjykata vëren se në fillim, autoritetet nuk nisën ndonjë hetim për pretendimet e kërkuesve. Në fakt, si përgjigje ndaj pretendimeve të Avokatit të Popullit se ata ishin keqtrajtuar, pa i marrë në pyetje kërkuesit, apo pa marrë dëshmi. Në 6 janar 2014, autoritetet mbrojtën pozicionin se kërkuesit nuk ishin keqtrajtuar (shih paragrafin 20 më sipër). Gjykata është e mendimit se kjo linjë

veprimi nuk pajtohet me kërkesën se autoritetet hetuese nuk mbështeten në përfundime të nxituara për të mbyllur hetimet e tyre. Ai vendim u arrit pa urdhëruar një kontroll mjekësor për lëndimet e pretenduara të kërkuësve të tjerë (shih paragrafin 51 më sipër).

58. Për sa i përket hetimeve që u kryen në kontekstin e procedurave që çuan në dënimin e kërkuësve, nuk rezulton se ato procedura ndoqën ndonjë linjë tjetër hetimesh përveç asaj që kishte të bënte me pengesën e oficerëve të policisë nga ana e kërkuësve. Për shembull, nuk u bë asnjë përpjekje për të konstatuar nëse pjesa tjetër e kërkuësve kishte pësuar lëndime, dhe nëse po, nëse lëndimet ishin shkaktuar nga përdorimi i forcës së pajustificuar nga oficerët e policisë. Gjithashtu, nuk u zhvillua asnjë hetim për pretendimet e kërkuësve se ata ishin përpjekur të kryenin kontroll mjekësor për lëndimet e tyre (shih paragrafin 14 më sipër) dhe për të paraqitur një ankesë penale. Së fundmi, Gjykata vëren se në procedurat gjyqësore, gjykatat vendase nuk kishin ndërmarrë hapa për të adresuar pretendimet e kërkuësve për keqtrajtim dhe për të sqaruar rrethanat për lëndimet e kërkuësve (shih paragrafët 27–28 më sipër).

59. Në tërësi, pavarësisht se pranohen vështirësitë për të ndjekur penalisht autoritetet në një çështje në të cilën ka pretendime për përdorim të tepruar force, në kontekstin ku personat në fjalë pretendohet se i kanë rezistuar policisë, Gjykata konstaton se autoritetet nuk kanë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për t'u përpjekur që t'i japin përgjigje një sërë pyetjesh të rëndësishme që dalin nga çështja, duke përfshirë edhe se si dhe kur oficerët e policisë përdorën forcë ndaj kërkuësve, nëse përdorimi i saj kishte qenë proporcional, dhe se çfarë i kishte shkaktuar lëndimet. Në lidhje me lëndimet që kishin marrë kërkuësit, këto janë të meta të rëndësishme në hetimin e çështjes konkrete (shih *Kuchta dhe Metel kundër Polonisë*, nr. 76813/16, §§ 88, 2 shtator 2021).

60. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se është shkelur neni 3 i Konventës sipas aspektit të tij procedural në lidhje me kërkuësin e dytë, të tretë dhe të pestë.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS

61. Kërkuësit u ankuan se duke hyre në kopshtin e tyre më 13 dhjetor 2013, oficerët e policisë iu kishin shkelur të drejtën për të mbrojtur banesën e tyre sipas nenit 8 të Konventës, i cili për sa ka të bëjë me çështjen, parashikon:

“Neni 8

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të ..., banesës së tij...”.
62. Qeveria deklaroi se kërkuësit nuk kishin shteruar zgjidhjet vendase për ankesën e tyre.
63. Kërkuësit parashtruan se oficerët e policisë nuk kishin paraqitur një raport që i lejonte hyrjen në banesën e tyre, sipas parashikimit të ligjit vendas.
64. Gjykata vëren se argumenti i kërkuësve ishte se oficerët kishin hyrë në kopshtin e tyre për shkak të organizimit të keq të operacionit, i cili synonte arrestimin e një të arratisuri. Duke pasur në konsideratë natyrën e ankesës, Gjykata dakordësohet me qëndrimin e Qeverisë se zgjidhjet ligjore civile, të tilla si masat për dëmshpërblim, mund të ofrojnë një zgjidhje për ankesën e kërkuësve. Pasi kërkuësit nuk ndërmorën procedura ligjore për këtë aspekt, ata nuk kanë shteruar zgjidhjet vendase.

65. Për këtë arsye, ankesa e paraqitur në mbështetje të nenit 8 të Konventës duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

III. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 14, NË LIDHJE ME NENIN 3 TË KONVENTËS

66. Kërkuësit u ankuan se pretendimi për shkeljen e të drejtave të tyre sipas nenit 3 të Konventës mbështetej në faktin se ata janë persona origjinë etnike rome, dhe për këtë arsye përballen me diskriminim, i cili parandalohet nga neni 14 i Konventës, i cili parashikon:

“Neni 14

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”.

67. Qeveria i kundërshtoi pretendimet e kërkuësve.

68. Gjykata thekson se në rastet kur autoritetet shtetërore hetojnë incidente të dhunshme, ata kanë detyrimin shtesë të ndërmarrin të gjitha masat e arsyeshme për të identifikuar nëse ka pasur motive raciste, si edhe për të përcaktuar nëse urrejtja ose paragjykimi etnik mund të kenë pasur ndikim në ngjarje ose jo. Megjithatë, në praktikë, është shumë e vështirë që të provohet motivimi racial. Detyrimi i Shtetit të paditur për të hetuar aspektet e mundshme raciste në një akt të dhunshëm është detyrim për të bërë përpjekjet më të mira dhe nuk është absolut. Autoritetet duhet të bëjnë atë që është e arsyeshme në rrethanat e caktuara për të mbledhur dhe për të siguruar të dhënat, të shfrytëzojnë të gjitha mjetet praktike për të zbuluar të vërtetën dhe për të ndërmarrë vendime të arsyetuara, të paanshme dhe objektive, pa hequr faktet e dyshimta që mund të jenë tregues të dhunës së ushtruar për arsye raciale (shih *B.S. kundër Spanjës*, nr. 47159/08, § 58, 24 korrik 2012, me referenca të mëtejshme).

69. Gjithashtu, detyra e autoriteteve për të hetuar ekzistencën e një lidhjeje të mundshme midis qëndrimeve raciste dhe një akti dhune është pjesë e aspektit të detyrimeve të tyre procedurale që dalin në mbështetje të nenit 3 të Konventës, por mund të konsiderohet edhe si aspekt i nënkuptuar në përgjegjësitë e tyre sipas nenit 14 të Konventës për të garantuar respekt pa diskriminim për vlerën themelore të parashikuar në nenin 3. Sipas këtyre dy dispozitave, problematikat e tilla si ato në çështjen konkrete mund të shqyrtohen vetëm sipas njërës prej këtyre dy dispozitave, pa ndonjë problematikë të veçantë të trajtuar nga dispozita tjetër, ose mund të shqyrtohen sipas të dy neneve. Kjo është një çështje që do të vendoset çështje pas çështje sipas fakteve përkatëse dhe në varësi të natyrës së pretendimeve të bëra (shih *B.S. kundër Spanjës*, cituar më sipër, § 59).

70. Duke u rikthyer në çështjen në fjalë, në lidhje me përfundimin e Gjykatës se nuk ka prova të mjaftueshme se kërkuësit e tjerë janë keqtrajtuar, ajo gjykon se nuk dalin problematika të tjera sipas nenit 14 të interpretuar në lidhje me pjesën thelbësore të nenit 3.

71. Mbetet për t’u përcaktuar nëse sipas nenit 14 të Konventës lind ndonjë problematikë tjetër e interpretuar në lidhje me pjesën procedurale të nenit 3, pasi Gjykata ka konstatuar një shkelje në lidhje me këtë të fundit. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se edhe pse pjesa tjetër e kërkuësve kishin parashtruar përpara autoriteteve vendase se ata ishin diskriminuar, ata nuk kishin raportuar ndonjë referencë për etninë e tyre në komunikimet që kishin pasur me autoritetet vendase (shih *a contrario*, *B.S. kundër Spanjës*, cituar më sipër, § 61). Gjithashtu, ata nuk kishin paraqitur rrethana të tjera ku të paraqitej qëndrimi diskriminues i autoriteteve vendase. Pavarësisht vështirësisë për të provuar motivacionin racial, në çështjen konkrete Gjykata e ka të pamundur të dallojë ndonjë element i cili do të mund të hapte rrugën drejt argumentit se moshetimi nga ana e autoriteteve i pretendimeve të kërkuësve përbën një problematikë të veçantë sipas nenit 14 të Konventës.

72. Në këtë mënyrë, Gjykata vendos se nuk lind asnjë problematikë tjetër sipas nenit 14, së bashku me nenin 3 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

73. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”.

A. Dëmshpërblimi

74. Kërkuesi i dytë, i tretë dhe i pestë kërkuar 15 000 euro (EUR) secili për dëmin monetar dhe jomonetar, që do të paguheshin në llogarinë bankare të Shoqërisë së Ndhmës Ligjore Tiranë (SHNLT), një organizatë jofitimprurëse e cila i kishte përfaqësuar gjatë procedurave të brendshme.

75. Qeveria pretendoi se kërkesa ishte e pajustificuar dhe e tepruar.

76. Duke marrë në konsideratë natyrën e shkeljes së konstatuar dhe parashtrimet e palëve, dhe vendimin në nivel të paanshëm, Gjykata i jep kërkuesit të dytë, të tretë dhe të pestë 4500 euro secilit për dëmin jomonetar, plus çdo taksë që mund të tarifohet mbi këtë shumë, e cila do të paguhet në llogarinë bankare të SHNLT-së, mbështetur në kërkesën e kërkuesve.

B. Kostot dhe shpenzimet

77. Kërkuesit e tjerë parashtruan se ata kishin marrë ndihmë ligjore falas nga SHNLT-ja dhe nuk kishin pretendime për kostot dhe shpenzimet.

78. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata nuk jep ndonjë shumë për këtë aspekt.

C. Interesi për pagesën e vonuar

79. Gjykata e gjykon me vend që norma e interesit për pagesën e vonuar duhet të mbështetet në normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, se cilit do t'i shtohen tre për qind pikë.

Për këto arsye, Gjykata:

1. *E deklaron* ankesën sipas nenit 8 të Konventës të papranueshme;
 2. *E deklaron* ankesën e kërkuesit të dytë, të tretë dhe të pestë të pranueshme sipas nenit 3 të Konventës, dhe ankesën e kërkuesit të parë dhe të katërt të papranueshme sipas atij parashikimi;
 3. *Gjykon* se është shkelur aspekti procedural i nenit 3 të Konventës për moshetimin nga ana e autoriteteve të pretendimeve të kërkuesit të dytë, të tretë dhe të pestë për keqtrajtim nga agjentët shtetërorë dhe se nuk është shkelur aspekti thelbësor i atij neni;
 4. *Gjykon* se nuk del asnjë problematikë e veçantë sipas nenit 14 së bashku me nenin 3 të Konventës;
 5. *Gjykon*:
 - a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit të dytë, të tretë dhe të pestë, brenda tre muajve 4500 euro (katër mijë e pesëqind euro) secilit, plus çdo taksë që mund të tarifohet për dëmin jomonetar, të cilat do të konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, dhe do të paguhet në llogarinë bankare të SHNLT-së;
 - b) se që prej përfundimit të tremujorit të sipërpërmendur deri në shlyerjen e plotë, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumën e mësipërme në një normë të barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonës së pagesës plus tre për qind pikë;
 6. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesve për kompensim të drejtë.
- Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 14 qershor 2022, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3, të Rregullave të Gjykatës.

Olga Chernishova
Zëvendëssekretare

Andreas Zünd
Kryetar

SHTOJCË

Lista e kërkuesve:

Kërkesa nr. 14800/18

Nr.	Emri i kërkuesit	Viti i lindjes	Kombësia	Vendbanimi
1	Edmond BALKASI	1975	Shqiptare	Tiranë
2	Besnik ALUSHI	1970	Shqiptare	Tiranë
3	Nikollaq ALUSHI	1993	Shqiptare	Tiranë
4	Nuri ALUSHI	1950	Shqiptare	Tiranë
5	Panajot ALUSHI	1990	Shqiptare	Tiranë